

EC MA NDRYSHE



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për mbikëqyrjen e punimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e mbikëqyrjes së punimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Mbikëqyrja e punimeve do të bëhet për ato projekte për të cilat ka nevojë Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për rehabilitimin e ujësjellësve, kanalizimeve dhe pusetave në Prizren dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e rehabilitimit të ujësjellësve, kanalizimeve dhe pusetave në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27493
Më 3.2.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejjimin e mjeteve për mbështetje financiare për OJQ “Finch”, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejjimin e mjeteve për mbështetje financiare për OJQ “Finch” për shënimin e Ditës Botërore të Ligatinave në Kosovë, që organizohet në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në vlerë 300 €.

Neni 2

Shuma e lejuar e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës, pozicioni i subvencioneve dhe mallrave të shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publiket, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Shoqata si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e hapësirës–oazës së gjelbër në Rr. “Wesli Clark”, dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e rregullimit të hapësirës–oazës së gjelbër në rrugën “Wesli Clark” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.2.2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Komisionit komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të objektit-pronë komunale, KRM “Ekoregjioni”-it në Prizren dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

- I. Miratohet propozimi i Komisionit komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të objektit-pronë komunale, KRM “Ekoregjioni”-it në Prizren, për nevojat e veta, kështu që, për këtë qëllim lejohet zhvillimi i procedurave ligjore për dhënie në shfrytëzim të objektit që gjendet në ngastrën kadastrorë nr. 8627/1 ZK Prizren, me një kohëzgjatje prej katër (4) vite.
- II. Objekti i lartcekur do të jepet në shfrytëzim duke u bazuar në Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144.
- III. Obligohet Komisioni komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim dhe organet tjera komunale kompetente, që të procedoj me lëndën në KPF dhe KK me qëllim të zhvillimit të procedurave të mëtutjeshme ligjore.
- IV. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Komisioni komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim dhe organet tjera kompetente.
- V. Me këtë konkluzion të njoftohen: Komisioni komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, organet tjera kompetente, KPF-ja, KK si dhe Arkivi.
- VI. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3.2.2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Komisionit komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, për lejimin e vazhdimin të kontratës për shfrytëzimin e objektit- pronë komunale nga ana e OJQ “Handikos” në Prizren dhe mori këtë:

KONKLuzion

- I. Miratohet propozimi i Komisionit komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, për lejimin e vazhdimin të kontratës për shfrytëzimin e objektit- pronë komunale nga ana e OJQ “Handikos” në Prizren, për nevojat e veta, kështu që për këtë qëllim lejohet zhvillimi i procedurave ligjore për vazhdimin e kontratës për shfrytëzimin e objektit, që gjendet në ngastrën kadastrorë nr. 3349 ZK -Prizren, me kohëzgjatje prej katër (4) vite.
- II. Objekti i lartcekur do të jepet në shfrytëzim duke u bazuar në Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144.
- III. Obligohet Komisioni komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim dhe organet tjera komunale kompetente, që të procedoj me lëndën në KPF dhe KK me qëllim të zhvillimit të procedurave të mëtutjeshme ligjore.
- IV. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Komisioni komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim dhe organet tjera kompetente.
- V. Me këtë konkluzion të njoftohen: Komisioni komunal për vlerësimin e ofertave për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, organet tjera kompetente, KPF-ja, KK si dhe Arkivi.
- VI. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadon Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për blerjen e sistemit numerik për nevojat e Zyrës Pritëse dhe mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e blerjes së sistemit numerik për nevojat e Zyrës Pritëse në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim dhe montim të garazheve montuese për autoveturat e Komunës së Prizrenit dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e furnizimit dhe montimit të garazheve montuese për autoveturat e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27499
Më 3.2.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e mjeteve për vaksinimin e qenve kundër tërbimit, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e mjeteve për vaksinimin e qenve kundër tërbimit (Rabies-it) kështu që për këtë qëllim nga buxheti i Komunës - pozicioni përkatës, lejohen mjetet në vlerë 7000 €, përkatësisht nga 2 € për çdo qen të vaksinuar.
- II. Shuma e lejuar e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural.
- III. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- IV. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave si dhe Arkivi.
- V. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e pendës ujitëse në Grazhdanik dhe për drenazhimin- kullimin e tokave në fshatin Dedaj dhe mori këtë:

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e ndërtimit të pendës ujitëse në Grazhdanik dhe për drenazhimin- kullimin e tokave në fshatin Dedaj, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me ushqim të koncentruar për peshq dhe mori këtë:

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e furnizimit me 10 tonë ushqim të koncentruar për peshq (hurdha), për nevojat e prodhuesve (kultivuesve) të peshkut të llojit “Trofta e Kalifornisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27504
Më 3.2.2015

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës me 3 shkurt 2015 mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Formohet dhe emërohet Komisioni për përgatitjen e konkursit, shqyrtimin e kërkesave dhe përzgjedhjen e kandidatëve për bursa të studentëve për vitin kalendarik 2015.
- II. Për anëtarë të këtij komisioni emërohen:
 - a. Nexhat Çoçaj - drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës – kryesues,
 - b. Ajradin Alija - përgjegjës i Zyrës për Komunitete - anëtarë,
 - c. Bashkim Lubovci nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa- anëtar.
- III. Detyrat e komisionit do të jenë: të përgatisë konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe fëmijët e dëshmorëve dhe për fëmijët e invalidëve të luftës, përgatitjen e konkursit me profile përkatëse, të përcaktojë kriteret e përfituesve të bursave, të shqyrtojë kërkesat dhe të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve për bursë komunale.
- IV. Komisioni nga pika II e këtij Aktvendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.
- V. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës dhe të emëruarit.
- VI. Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës, të emëruarit dhe Arkivi.
- VII. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramazan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27506
Më 3.2.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së konkursit për ndarjen e bursave për vitin kalendarik 2015 kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

- a. Lejohet shpallja e konkursit për ndarjen e bursave për vitin kalendarik 2015 për studentët të cilët studiojnë në universitetet publike të Republikës së Kosovës dhe për nxënës të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të UÇK-së të shkollave të mesme dhe fillore.
- b. Për studentë të përshkruar si në pikën a) të nenit 1 të këtij Vendimi, lejohet shpallja e konkursit për ndarjen e 80 bursave për studentë dhe 40 bursave për nxënës të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të UÇK-së.
- c. Për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme në vlerë prej 50.000 € (40.000 € për bursa të studentëve dhe 10.000 € për nxënësit e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të UÇK-së).

Neni 2

Shuma e lejuar e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, komisioni përkatës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e shpalljes së tenderit për rregullimin e rrethojës së oborrit të ShFMU “Nazim Kokollari” në Prizren dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejin e rregullimit të rrethojës së oborrit të Shkollës Fillore të Mesme të Ultë “Nazim Kokollari” në Prizren, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e murit mbrojtës të oborrit të ShFMU “Svjetlost” në Manastiricë dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e rregullimit të murit mbrojtës të oborrit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët “Svjetlost” në Manastiricë, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për punimin e fasadës termike të objektit të ShFMU “Meto Bajraktari” në Reçan dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e punimit të fasadës termike të objektit të shkollës fillore të mesme të ultë “Meto Bajraktari” në Reçan, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27508
Më 3.2.2015

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejjimin e mbajtjes së manifestimit tradicional kushtuar 7 Marsit– Ditës së Mësuesit, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejjimin e mbajtjes së manifestimit tradicional kushtuar 7 Marsit– Ditës së Mësuesit dhe për lejjimin e mjeteve për organizimin dhe shënimin e këtij manifestimit, andaj për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në vlerë 3350 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin I të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave si dhe Arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27513
Më 3.2.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Rural, për formimit të komisionit për shënimin e përvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Formohet dhe emërohet Komisioni për shënimin e përvjetorit të shtatë të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- II. Për anëtarë të këtij Këshilli, emërohen:
 1. Kujtim Gashi - kryetar,
 2. Lulëzim Ibri
 3. Urim Ukimeri dhe
 4. Zeqir Xhaferaj - anëtar
- III. Detyrat e Komisionit do të jenë: Të përgatisë projektin për organizimin e të gjitha aktiviteteve rreth shënimit të këtij përvjetori, të mbledhë dhe verifikojë të gjitha shpenzimet e bëra dhe ato t'i procedoj për pagesë me fatura.
- IV. Lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me shënimin e përvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- V. Mjetet lejohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe drejtorive tjera komunale.
- VI. Komisioni, nga pika II e këtij Aktvendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.
- VII. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të emëruarit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27515
Më 3.2.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimit të mjeteve për pagesë të faturës së KRU “Hidroregjioni Jugor” ShA , kryetari i Komunës, më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimit të mjeteve financiare për pagesë të faturës së KRU “Hidroregjioni Jugor” ShA Prizren, për kycjen në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit të objektit të ri të Bibliotekës së qytetit, kështu që për këtë qëllim dhe në emër të pagesës së faturës, lejohen mjetet në vlerë 1102 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave dhe shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorive tjera komunale .
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KRU “Hidroregjioni Jugor” si dhe Arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e shpalljes së tenderit për blerjen e automjeteve për nevojat e kësaj Drejtorie dhe mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e blerjes së automjeteve për nevojat e kësaj Drejtorie, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e shpalljes së tenderit për marrjen dhe dërgimin e mostrave për analiza dhe mori këtë:

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e marrjen dhe dërgimin e mostrave për analiza sipas rasteve dhe kërkesave të Drejtorisë dhe palëve kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e shpalljes së tenderit për intervenim në infrastrukturën komunale ku mund të ketë qasje inspektorati dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e intervenimit në infrastrukturën komunale ku mund të ketë qasje inspektorati i Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e shpalljes së tenderit për ngritjen dhe profesionalizimin e stafit të kësaj Drejtorie dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e ndjekjes së trajnimeve përkatësisht për ngritjen dhe profesionalizimin e stafit të kësaj Drejtorie, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Inspektorateve, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me inventar për nevojat e shëndetësisë primare dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e furnizimit me inventar për nevojat e shëndetësisë primare, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për mirëmbajtjen dhe renovimin e objekteve shëndetësore dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mirëmbajtjes dhe renovimit të objekteve shëndetësore të shëndetësisë primare, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e ashensorëve dhe shkallëve emergjente në QKMF dhe në QMF-1 dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e ndërtimit të dy ashensorëve dhe shkallëve emergjente në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare 1, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për revidimin e projektit të ndërtimit të banesave për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe rasteve skamnor dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e revidimit të projektit të ndërtimit të banesave për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe rasteve skamnor të komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me kompjuter për nevojat e QPS-së dhe mori këtë:

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e furnizimit me kompjuter për nevojat e Qendrës për Punë Sociale, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e tri (3) projekteve kapitale dhe mori këtë:

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e realizimit të disa projekteve kapitale të kësaj Drejtorie, kështu për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për:

1. Furnizim me pajisje të vogla brenda Drejtorisë,
2. Studimin e fizibilitetit për rrufepritës dhe
3. Projektin për aftësimin dhe sensibilizimin e qytetarëve.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27522
Më 3.2.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/L-204 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 04/2011 si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

A K T V E N D I M


1. Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e patundshmërive, caktimin e bazës tatimore për tatimin në pronë, rishikimin e zonave tatimore dhe hartimin e projekt rregullores mbi aplikimin e Tatimit në Pronën e Paluajtshme në komunën e Prizrenit, për vitin 2016.

Anëtarë të këtij komisioni emërohen:

- 1.1. Ismet Rama nga DEF,
- 1.2. Agadir Zenelaj nga DEF,
- 1.3. Refki Musbegu nga DUPH,
- 1.4. Dukagjin Berisha nga DGJK,
- 1.5. Sefer Avduti nga Sektori i Pronës,

2. Komisioni në mbledhjen e parë do ta zgjedhë kryesuesin e komisionit.
3. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë të parapara në Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/L-204 dhe Udhëzimit Administrativ për caktimin e vlerës së pronë së paluajtshme dhe standardet e vlerësimit nr. 04/2011, si dhe në nenin I të këtij Aktvendimi.
4. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.
5. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa si dhe të emëruarit.
6. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27527
Më 3.2.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit dhe Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/L-204, pas propozimit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, kryetari i Komunës me 3 shkurt 2015 mori këtë:

AKTVENDIM

Për formimin, përbërjen, emërimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit për Shqyrtimin e Ankesave nga Tatimi në Pronë

1. Formohet dhe emërohet Bordi për shqyrtimin e ankesave nga tatimi në pronë në komunën e Prizrenit për vitin 2015.
Anëtarë të këtij komisioni emërohen:
 - 1.1. Islam Osmankaj – kryetar,
 - 1.2. Emire Mashkulli – anëtare,
 - 1.3. Bashkim Lubovci – anëtar.
2. Komisioni, nga pika I e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.
3. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
4. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria për Ekonomi dhe Financa si dhe të emëruarit.
5. Me këtë Aktvendim, të njoftohen Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, të emëruarit, Departamenti i Tatimit në Pronë si dhe Arkivi.
6. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramazan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27532
Më 3.2.2015



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për formimin dhe emërimin e Komisioni për caktimin e kriterëve dhe kushteve për shfrytëzimin e shtandeve për shitje dhe të Info Qendrave turistike në Prizren.
2. Anëtarë të këtij komisioni emërohen:
 - 2.1. Shkodran Kryeziu nga DTZhe - kryesues.
 - 2.2. Fejsal Hoti nga DShP,
 - 2.3. Refki Musbegu nga DUPH,
 - 2.4. Rrahim Destani nga DI,
 - 2.5. Bashkim Lubovci nga DEF,
 - 2.6. Visar Islamaj nga ZL,
 - 2.7. OJQ-të,
 - 2.8. Këshilli i Trashëgimisë Kulturore, dhe
 - 2.9. Instituti për Mbrojtje të Monumenteve, anëtar.
3. Detyrat e Komisioni nga pika 2 e këtij Aktvendimi janë: caktimi i kriterëve dhe kushteve për shfrytëzimin e shtandeve për shitje e produkteve dhe eksponateve të ndryshme dhe për mënyrën e shfrytëzimit dhe vendosjes së Info Qendrave turistike në Prizren
4. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.
5. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik si dhe të emëruarit
6. Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Turizmi dhe Zhvillimi Ekonomik, të emëruarit si dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-27534

Më 3.2.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare të Shoqatës së të Verbërve, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Zyrës për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për Shoqatën e të Verbërve lidhur me realizimin e projektit “Orientimi në hapësirë”. Ky projekt ofron trajnime, mësim për përdorimin e shkopit të bardhë, pavarësi më të madhe në rrethin jetësor etj, të personave të verbërve, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në vlerë 800 €.
- II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin I të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, shoqata si dhe arkivi.
- V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-19972
Më 3.2.2015

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shkurt 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me material ndërtimor për meremetimin-ndërtimin e disa shtëpive të familjeve skamnore të komunitetit minoritar dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e furnizimit me material ndërtimor për meremetimin-ndërtimin e disa shtëpive të familjeve skamnore të komunitetit minoritar, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27540
Më 3.2.2015




Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të mbushjeve telefonike për zyrtarët e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e mjeteve financiare për pagesë të mbushjeve telefonike për zyrtarët e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në vlerë të përgjithshme prej 70 € në muaj, për vitin 2015 për zyrtarët si në vijim:
 - 1.1 Islam Elshani.....-mbushje telefoni në vlerë 20 €,
 - 1.2 Asim Imeri..... mbushje telefoni në vlerë 20 €,
 - 1.3 Spasa Andrijeviç... mbushje telefoni në vlerë 10 €,
 - 1.4 Slobodanka Kuqan-mbushje telefoni në vlerë 10 €,
 - 1.5 Rahim Xhaferi.....mbushje telefoni në vlerë 10 €,
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit si dhe arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja,



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27544
Më 3.2.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunikim dhe Informim për lejimin e hartimit të strategjisë së Informimit në komunën e Prizrenit, për periudhën 2015-2019 kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunikim dhe Informim, për lejimin e hartimit të strategjisë së Informimit në komunën e Prizrenit, për periudhën 2015-2019.
- II. Strategjia e Informimit në komunën e Prizrenit, për periudhën 2015-2019, do të hartohet nga Zyra për Informim e Komunës së Prizrenit, në bashkëpunim me OSBE-në dhe OJQ-të vendore.
- III. Pas hartimit të Draft Strategjisë së lartcekur e njëjta do t'i nënshtrohet procedurave të rregullta ligjore për miratim në Komitetin për Politikë dhe Financa në Kuvend të Komunës.
- IV. Për realizimin e kësaj strategjie –projekti, lejohen mjetet në vlerë 5000 €.
- V. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin IV të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
- VI. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunikim dhe Informim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
- VII. Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunikim dhe Informim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OSBE-ja, OJQ-të, si dhe arkivi.
- VIII. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27550
Më 3.2.2015

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Sllovenisë dhe pagesës së mëditjeve për Lulëzim Kabashin, nënkryetar i Komunës së Prizrenit, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015 miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet udhëtimi zyrtar i Lulëzim Kabashit, nënkryetar i Komunës së Prizrenit, për në Republikën e Sllovenisë, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitën studimore që organizohet nga ARDA në bashkëpunim me Komisionin Evropian në Kosovë, e që ka të bëjë me njohurit mbi zhvillimin rajonal si dhe aspektet organizative e operacionale në Slloveni.

Vizita studimore do të realizohet nga data 1 shkurt deri me 6 shkurt 2015, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra e Nënkyetarit të Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra e Nënkyetarit të Komunës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-27553
Më 3.2.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës-Sektorit të Gjendjes Civile, për lejimin e mjeteve për furnizim me certifikata të gjendjes civile për vitin 2015, kryetari i Komunës më 3 shkurt 2015, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Sektorit të Gjendjes Civile, për lejimin e furnizimit me certifikata të gjendjes civile për vitin 2015 për nevojat e Sektorit të Gjendjes Civile të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave dhe shërbime.

Neni 3

Furnizimi me certifikata të gjendjes civile do të bëhet sipas kontratës kornizë të nënshkruar në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Prishtinë dhe operatorit ekonomik i cili është fitues i tenderit përkatës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës- Sektori i Gjendjes Civile, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës- Sektori i Gjendjes Civile, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, MPB, si dhe arkivi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja